



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.105

2005

janar

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9454 datë 21.12.2005	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar.....	3329
Ligj nr.9455 datë 21.12.2005	Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	3331
Ligj nr.9456 datë 21.12.2005	Për disa ndryshime në ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.....	3335
Ligj nr.9457 datë 21.12.2005	Për një ndryshim në ligjin nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”.....	3337
Ligj nr.9458 datë 21.12.2005	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.....	3337
Ligj nr.9459 datë 21.12.2005	Për disa ndryshime dhe një shtesë në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar.....	3339
Ligj nr.9460 datë 21.12.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	3341
Ligj nr.9461 datë 21.12.2005	Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore.....	3343

L I G J
Nr.9454, datë 21.12.2005

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në fund të pikës 5 të nenit 10 “Furnizimet e përziera” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Pika 5 e këtij neni nuk zbatohet në rastin e shoqërive të ndërtimit, të cilat ndërtojnë për të shitur, pavarësisht nga fakti se sipërmarrësi i punimeve dhe investitori janë i njëjti person i tatueshëm. Në këtë rast furnizimi i procesit të ndërtimit është i tatueshëm, sipas rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave.”.

Neni 2

Neni 20 “Toka dhe ndërtesat” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

1. Furnizimi i tokës dhe i truallit ose dhënia me qira e tyre është një furnizim i përjashtuar, përveç rasteve të shfrytëzimit për parking ose magazinim të mjeteve të transportit dhe të mjeteve të tjera lëvizëse.

2. Furnizimi i ndërtesave, përveç procesit të ndërtimit, është një furnizim i përjashtuar.

3. Dhënia me qira e ndërtesave, pronë publike, nga organet e pushtetit qendror ose vendor, është furnizim i përjashtuar.”.

Neni 3

Neni 25/3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25/3

Shitja e librave, e gazetave, e revistave dhe shërbimet e reklamave në to

Përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetat, furnizimi i gazetave, i revistave dhe i librave të çdo lloji, si dhe furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar dhe nga media elektronike.”.

Neni 4

Pas nenit 25/6 shtohet neni 25/7 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/7

Furnizimet e shërbimeve të lojërave të fatit, kazinove dhe hipodromeve janë furnizime të përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar.”.

Neni 5

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

Vlera minimale e tatueshme

Çmimi orientues minimal fiskal, për procesin e ndërtimit të banesave, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave pas këshillimit me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë.”.

Neni 6

Në nenin 31 shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) furnizimet e mallrave e të shërbimeve, në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave ose të pasagjerëve;”.

Neni 7

Në nenin 42 “Rishqyrtimet” fjalia e dytë e pikës 7 shfuqizohet.

Neni 8

Neni 54 “Nxjerrja e tatimit të papaguar” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 54

Nëse TVSH-ja e detyruar, në mbështetje të këtij ligji, nuk është paguar deri në datën, në të cilën është e detyrueshme, organet tatimore kanë të drejtë të ndërmarrin veprime për të nxjerrë me forcë TVSH-në e detyruar, së bashku me interesat apo gjokat e vëna, sipas neneve 45 e 46 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

Neni 9

Në nenin 57 paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Kur shkeljet e mësipërme nuk përbëjnë vepër penale, ato dënohen me gjobë. Ministri i Financave cakton me udhëzim kriteret e hollësishme për masën e dënimit me gjobë, sipas këtyre shkeljeve, në kushte e rrethana të përcaktuara.”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr., datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

L I G J

Nr.9455, datë 21.12.2005

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË LIGJIN NR.8977, DATË 12.12.2002 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Në ligjin nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 6 pika 13 ndryshohet si më poshtë:

“13. Për taksën e kalimit me avion të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë nga aeroporti “Nënë Tereza” ngarkohet shoqëria “Tirana Airport Partners shpk”.”.

Neni 2

Në nenin 10 pika 4 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) automjetet e regjistruara në territorin e Kosovës.”.

Neni 3

Lidhja nr.5, që i referohet pikës 9 të nenit 5 të ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen nr.5, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 4

Në nenin 5 pika 13 ndryshohet si më poshtë:

“13. Taksa e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë caktohet 10 euro.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr., datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

LIDHJA NR. 5

TAKSA PËR VEPRIMET DHE SHËRBIMET QË KRYHEN NGA ADMINISTRATA
GJYQËSORE, MINISTRIA E DREJTËSISË, NOTERIA, ZYRAT E REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PROKURORIA DHE ZYRAT E GJENDJES CIVILE

Masa e taksës
në lekë

në %

Taksa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria:		
Për regjistrimin e personave fizikë e juridikë privatë (shtetas shqiptarë)	1 000	
2. Për regjistrimin e personave juridikë privatë (shtetas të huaj)	1 000	
3. Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit	100	
4. Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit	100	
5. Për lëshimin e dëshmisë së penaltetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore	100	
6. Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Drejtësisë	100	
7. Kërkesë padi që paraqiten në gjykatë:		
a) për pension ushqimor	-	
b) për vërtetim fakti	100	
c) padi për zgjidhje martese	1 500	
ç) padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike	1 500	
d) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe për shkaktim dëmi:		
i) me vleftë deri në 100 000 lekë	1 500	
ii) me vleftë mbi 100 000 lekë		1%
dh) padi për pjesëtim pasurie	1 500	
e) padi për kthim në punë	-	
B. Taksë për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor:		
Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të pavleftësueshëm	750	
2. Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të vleftësueshëm:		
a) kundrejt shtetasve		3%
b) kundrejt personave juridikë		7%
3. Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përmbaruesit gjyqësor	100	
4. Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit	100	
5. Për vënien në ekzekutim të vendimeve me objekt pension ushqimor	-	
	Masa e taksës në lekë	në %
C. Taksat për veprimet që kryhen nga		

zyrat noteriale:

1. Përpilimi i testamenteve me akte noteriale	450
2. Përpilimi i testamenteve olografe (me vërtetim firme)	200
3. Prokura (redaktim):	
a) të përgjithshme	150
b) të posaçme	150
4. Për lëshimin e kopjeve, shkurtime e pjesë të akteve të depozituara në zyrën noteriale	150
5. Vërtetim se kopjet ose shkurtime e dokumenteve janë të njëjta me origjinalin	150
6. Vërtetim përkthimi dhe vërtetim njësie me origjinalin	100
7. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së luajtshme	700
8. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së paluajtshme	1 000
9. Redaktimi i akteve noteriale të ndryshme	150
10. Njoftim dhe kujtesë noteriale ose akte të tjera jashtëgjyqësore	150
11. Legalizim i nënshkrimit të shtetasve në akte të ndryshme	100
12. Depozitimi i kapitalit themelor për themelimin e një shoqërie në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 «Për shoqëritë tregtare»	300
13. Pranimi për ruajtje të dokumenteve të personave fizikë dhe juridikë në zyrat noteriale	300
14. Vërtetimi i qenies së një personi dhe qëndrimi i tij në një vend të caktuar	150
15. Veprime të tjera noteriale	100
Ç.Taksat për veprimet që kryhen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme:	
1. Kërkesa për regjistrimin e pronësisë të pasurisë së paluajtshme	300
2. Kërkesa për regjistrimin e pjesëtimit, ndarjes ose bashkimit të pasurisë së paluajtshme	300
3. Kërkesa për përgatitjen e dokumenteve për në gjykatë ose organ tjetër administrativ	150
4. Kërkesa për regjistrimin për kalim pronësie, qiraje, nënqiraje	300
5. Kërkesa për regjistrim hipoteke ligjore	150
6. Kërkesa për regjistrim përfshirje hipoteke ligjore	150
Masa e taksës në lekë	

në %

7. Kërkesa për regjistrim përfshirjen e një vendimi gjykate a të një akti administrativ	150
8. Kërkesa për regjistrim servituti, marrëveshjeje kufizuese	150
9. Kërkesa për regjistrim për fshirjen e një servituti, marrëveshjeje kufizuese	150
10. Regjistrimi i kërkesave për heqjen dorë nga të drejtat pasurore mbi pasurinë e paluajtshme	100
11. Regjistrimi i kërkesave për fitimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me trashëgimi	300
12. Kërkesa për regjistrimin e veprimeve juridike mbi pasurinë paluajtshme nga personat fizikë dhe juridikë me banim jashtë shtetit	300
13. Për lëshimin e certifikatave të pasurisë	100
14. Për lëshimin e çdo kopjeje të certifikatës së pasurisë	50
15. Për lëshimin e çdo akti të të interesuarve për veprimet hipotekore	50

D. Taksa e akteve dhe e pullës:	
Për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile	50
2. Për lëshimin e pasaportave për brenda vendit	100
3. Për marrjen e çdo akti të emetuar ose të zhdukur të gjendjes civile, si dhe për korrigjimet e tyre	50
4. Për regjistrimin e dhënies së shtetësisë	700
5. Për regjistrimin e lënies së shtetësisë	700
6. Për regjistrimin e vendimit të ndërrimit të emrit ose mbiemrit	700
7. Për çdo lidhje martesë	600

L I G J

Nr.9456, datë 21.12.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8982, DATË 12.12.2002 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

a) Aneksi nr.4 “Taksa vjetore për regjistrimin e përvitshën të mjeteve të transportit rrugor”, që i referohet pikës 2, zëvendësohet me aneksin 4, që i bashkëlidhet këtij ligji;

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, drejtoritë rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të mjetit. Taksa derdhet për llogari të bashkisë ose të komunës, sipas vendbanimit ose selisë së pronarit të mjetit, brenda datës 10 të muajit pasardhës.”.

c) Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Policia e Qarkullimit Rrugor kontrollon pagimin e kësaj takse nga zotëruesit e mjeteve dhe, kur vëren se nuk është paguar, zbaton një gjobë të barabartë me masën e taksës. Nëse taksa dhe/ose gjoba nuk paguhet brenda 10 ditëve, ajo bllokton mjetin deri në pagesën e tyre.”.

ç) Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Për mjetet, që regjistrohen për herë të parë, taksa paguhet e plotë, pavarësisht nga periudha e regjistrimit dhe është e vlefshme për 365 ditë.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr., datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

ANEKSI 4

Taksat vjetore për regjistrimin e përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor

Nr.	Tipi i mjetit	Taksë regjistrimi (në lekë)
1	Çiklomotorë	0
2	Motomjete	600
3	Automjete: Autoveturë ≤4+1 vende, benzinë Autoveturë ≤4+1 vende, naftë Autoveturë >4+1 deri ≤ 8+1 vende, benzinë Autoveturë >4+1 deri ≤ 8+1 vende, naftë	2 400 2 400 4 800 4 800
4	Automjet transporti i përzier deri 3t Automjet transporti i përzier 3t deri ≤3,5t	3 600 3 600

5	Kamion: Nga 3,5t – 7,5t Nga 7,5t – 18t Më i madh se 18t	4 800 6 000 8 000
6	Autobuzë: Nga 8+1 deri <=32+1 vende >32+1 deri <=42+1 vende Mbi 42+1 vende, artikularë	6 000 7 200 8 400
7	Automjet për përdorim të veçantë: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <=7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18t	3 600 4 800 6 000 8 000
8	Automjet për transport të veçantë: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga >7,5t deri <=18t Më i madh se 18t	3 600 4 800 6 000 8 000
9	Tërheqës rrugor	6 000
10	Autokamp	4 800
11	Rimorkio: <= 750 kg (karrel) shtojcë nga > 750kg deri në <= 1500 kg Nga > 1500 kg deri në <= 7000 kg Më i madh se 7000 kg	3 000 3 000 3 000 4 000
12	Gjysmë rimorkio: <=7000 kg dhe > 7000 kg	4 000
13	Makina bujqësore: <= 3,5t Nga 3,5t deri <=7,5t Nga >7,5t deri <= 18t Më i madh se 18t	3 000 3 000 3 600 3 600
14	Makina teknologjike: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <= 7,5t Nga > 7,5t deri <=18t Më i madh se 18t	3 600 4 800 6 000 8 000
15	Mjete rrugore të veçanta: <= me 3,5t Nga 3,5t deri <=7,5t Nga > 7,5t deri <= 18t Më i madh se 18t	3 600 4 800 6 000 8 000

L I G J
Nr.9457, datë 21.12.2005

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9136, DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E
KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE
SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e

Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në shkronjat "c" e "ç" të pikës 1 të nenit 11 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", data 10 zëvendësohet me datën 20.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4737, datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9458, datë 21.12.2005

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 "PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimim mbi të ardhurat", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Tabela nr.1, që i bashkëlidhet ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, zëvendësohet me tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Neni 12 "Fitimet nga lojërat e fatit dhe kazinotë" shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 13 pikat 3 e 4 shfuqizohen.

Neni 4

Në fund të nenit 18 "Përjashtimet" shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Të gjitha subjektet e përmendura në shkronjën "a" deri në shkronjën "ë" të këtij neni,

pavarësisht nga përjashtimi nga pagimi i tatimit mbi fitimin, janë të detyruara të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe bilancin kontabël vjetor, në të njëjtat afate si subjektet, që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin."

Neni 5

Në nenin 22 pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Amortizimi për kostot e blerjes së aktiveve të patrupëzuara llogaritet veç për secilin aktiv, sipas metodës lineare, në masën 15 për qind."

Neni 6

Neni 23 "Inventari" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 23 Inventari

Inventari, në fund të periudhës tatimore, vlerësohet sipas njërës nga metodat e përcaktuara në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe duhet të zbatohet në mënyrë sistematike."

Neni 7

Neni 28 "Shkalla tatimore" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 28 Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin është 20 për qind."

Neni 8

Në nenin 33 pika 4 shfuqizohet.

Neni 9

Pas nenit 33 shtohet neni 33/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 33/1 Destinimi i fitimit

1. Shoqëritë tregtare, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, në përputhje edhe me dispozitat e nenit 56 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", të ndryshuar, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë, në Asamblenë e Ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë, rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahej në formë dividendi.

2. Shoqëritë tregtare duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik, vendimin e organit përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij neni. Për paraqitjen me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekësh, për çdo muaj apo pjesë të muajit.

3. Personi juridik duhet të derdhë për llogari të organit tatimor tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1 të këtij neni, jo më vonë se data 30 korrik e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo pagesa e dividendit."

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr., datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

TABELA NR.1
TABELA PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA PUNËSIMI

E ardhura e tatueshme (në muaj)	TAP		Përqindje
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	Lekë	
0	14 000	0	+1 % të shumës mbi 0 lekë
14 000	40 000	140	+ 5% të shumës mbi 14 000 lekë
40 000	90 000	1 440	+ 10% të shumës mbi 40 000 lekë
90 000	200 000	6 440	+ 15% të shumës mbi 90 000 lekë
200 000	Më tepër	22 940	+ 20% të shumës mbi 200 000 lekë

L I G J
Nr.9459, datë 21.12.2005

**PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8701, DATË 1.12.2000 “PËR
LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË DHE HIPODROMET”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10 "Detyrimet tatimore", në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi “i” i shkronjës “a” ndryshohet si më poshtë:

"i) organizatori i lojës bingo që zhvillohet për pjesëmarrës brenda sallës, paguan një tatim për lojërat e fatit me një kuotë fikse, çdo muaj, për çdo sallë, përkatësisht 500 000 lekë për rrethet e kategorisë së parë, 400 000 lekë për rrethet e kategorisë së dytë dhe 300 000 lekë për rrethet e kategorisë së tretë;”.

2. Paragrafi “ii” i shkronjës “b” ndryshohet si më poshtë:

"ii) organizatori i basteve sportive paguan tatim mbi lojërat e fatit me kuotë fikse, si më

poshtë:

- 1 000 000 lekë çdo muaj për shoqërinë;
- 40 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së parë;
- 30 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së dytë;
- 20 000 lekë për çdo pikë shitjeje të basteve, për rrethet e kategorisë së tretë;"

3. Paragrafët "i", "ii" dhe "iii" të shkronjës "c" ndryshohen si më poshtë:

"i) për rrethet e kategorisë së parë, 30 000 lekë në muaj, për çdo kompjuter elektronik, si edhe 40 000 lekë në muaj, për çdo pozicion loje të makinës elektronike;

ii) për rrethet e kategorisë së dytë, 20 000 lekë në muaj për çdo kompjuter elektronik, si edhe 30 000 lekë në muaj për çdo pozicion loje të makinës elektronike;

iii) për rrethet e kategorisë së tretë, 14 000 lekë në muaj për çdo kompjuter elektronik, si dhe 20 000 lekë në muaj për çdo pozicion loje të makinës elektronike;"

Neni 2

Në nenin 22 "Detyrimi tatimor për kazinotë", në pikën 4 shkronjat "a", "b" dhe "c" ndryshohen si më poshtë:

"a) për çdo tavolinë të lojës së fatit ruletë, një taksë mujore në masën 800 000 lekë;

b) për çdo tavolinë të lojërave me letra dhe me zare, një taksë mujore në masën 600 000 lekë;

c) për lojërat elektronike dhe sllot makinat me fitim në çast, të vendosura në mjediset e kazinosë, një taksë mujore 60 000 lekë për çdo kompjuter elektronik. Për makinat elektronike me më shumë se një pozicion, një taksë mujore 80 000 lekë në muaj për çdo pozicion;"

Neni 3

Në nenin 25 "Detyrimi tatimor për hipodromet", në pikën 4 shkronjat "a", "b" dhe "c" ndryshohen si më poshtë:

"a) një tatim loje fati me kuotë fikse, çdo muaj, prej 2 000 000 lekësh për shoqërinë;

b) një tatim loje fati me kuotë fikse, çdo muaj, prej 40 000 lekësh për çdo pikë të shitjes së basteve;

c) për lojërat elektronike me fitim në çast, të vendosura në mjediset e hipodromit, një tatim me kuotë fikse, çdo muaj, prej 40 000 lekësh për çdo kompjuter elektronik ose pozicion të makinës elektronike;"

Neni 4

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 27/1

Sanksionet në fushën e tatimeve

1. Mosdeklarimi dhe mospagesa e një shume detyrimi tatimor, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 50 për qind të shumës së detyrueshme për t'u paguar.

2. Pagesa e vonuar e detyrimit tatimor për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në masën 10 për qind të shumës së paguar jashtë afatit.

3. Për mospagimin në afat të detyrimeve tatimore, përveç dënimeve të mësipërme, kundërvajtësi paguan edhe interesat për pagesën e vonuar, në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4737, datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9460, datë 21.12.2005

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8560, DATË 22.12.1999 “PËR
PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 30 “Pajisja me certifikatë tatimore”, në fund të pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Personat e tatueshëm kanë selinë qendrore në vendin e menaxhimit efektiv të biznesit. Kriteret për përcaktimin e vendit efektiv të biznesit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji.”.

Neni 2

Në fund të nenit 36 “Metodat alternative të përcaktimit të detyrimit tatimor” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për zbatimin e shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve këshillohet me shoqatat e specializuara të biznesit, për të përcaktuar vlerën orientuese të tatueshme, në bazë të së cilës bëhet përcaktimi i detyrimeve tatimore. Vlera orientuese e tatueshme përcaktohet me akte nënligjore.”.

Neni 3

Në nenin 53 “Shkeljet dhe dënimet për moslejimin e hyrjes dhe të kontrollit”, pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Në çdo rast, të drejtën e dënimit me gjobë, sipas pikës 1 të këtij neni, e ka kryetari i degës së tatimeve.”.

Neni 4

Në nenin 55 “Procedurat e apelimit”, në fund të pikës 3 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Për qëllime të këtij ligji ose të ligjeve të tjera tatimore, datë e marrjes së njoftimit të vlerësimit apo të njoftimeve të tjera zyrtare, vlerësohet dita e dhjetë pas dorëzimit të njoftimit në shërbimin postar. Përgjegjësia për mosmarrjen në kohë të njoftimit të dorëzuar në shërbimin postar është e tatimpaguesit, i cili është i detyruar të deklarojë adresën e saktë, që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve nga shërbimi postar.

Administrata tatimore mund ta dërgojë njoftimin e vlerësimit ose njoftimet e tjera zyrtare dorazi. Në këtë rast, datë e marrjes së njoftimit vlerësohet data, kur njoftimi i jepet në dorë tatimpaguesit dhe konfirmohet nga ky i fundit. Në rast refuzimi nga tatimpaguesi, njoftimi vlerësohet i marrë në datën e refuzimit.”.

Neni 5

Në fund të nenit 56 “Procedurat e shqyrtimit të apeliimeve tatimore” shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Në rastin e një apeliimi tatimor, organi që ka të drejtën e shqyrtimit të apeliimit ka, gjithashtu, të drejtën të heqë tërësisht apo pjesërisht dënimet, pavarësisht nga fakti nëse detyrimi për tatimin qëndron ose jo.”.

Neni 6

Neni 57 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 57

Për shqyrtimin e apeliimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve krijohet Drejtoria e Apeliimeve Tatimore, si pjesë përbërëse e strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtori i Drejtorisë së Apeliimeve Tatimore emërohet nga Ministri i Financave. Drejtoria e Apeliimeve Tatimore ka autoritetin e nevojshëm për të shqyrtuar apeliimet që kanë të bëjnë me vlerësimet tatimore, të paraqitura nga tatimpaguesit, përfshirë edhe të drejtën për të kryer hetime, kontrolle dhe rillogaritje të detyrimeve tatimore. Në bazë të shqyrtimit të apeliimeve, ajo merr vendimin përkatës. Drejtoria e Apeliimeve Tatimore është e pavarur në vendimmarrje. Vendimi i kësaj Drejtorie duhet të jetë i argumentuar dhe të merret jo më vonë se 30 ditë nga data, kur është paraqitur kërkesa për apelim nga tatimpaguesi. Mosmarrja e vendimit për rezultatin e apeliimit brenda afatit dhe mosdërgimi i tij tek tatimpaguesi, i jep të drejtën tatimpaguesit për t'u ankuar në shkallën tjetër më të lartë të apeliimit, pa paraqitur rezultatin e shqyrtimit të shkallës më të ulët të apeliimit.”.

Neni 7

Pas nenit 72 shtohet neni 72/l me këtë përmbajtje:

“Neni 72/1

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për zbatim si për tatimpaguesit dhe për administratën tatimore, edhe për administrimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4737, datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

L I G J

Nr.9461, datë 21.12.2005

PËR NOMENKLATURËN E MALLRAVE DHE TARIFËN DOGANORE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të

Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

1. Për të pasur një instrument të vetëm, që do të mundësonte administrimin në të njëjtën kohë të tarifës doganore, të statistikave të tregtisë së jashtme dhe të politikave të tjera, që lidhen me mallrat dhe lëvizjen e tyre, Këshilli i Ministrave miraton një nomenklaturë mallrash, e cila, nga këtu e më tej, do të quhet “Nomenklatura e Mallrave” (NM).

2. Nomenklatura e Mallrave bazohet plotësisht në Nomenklaturën e Kombinuar të Bashkimit Europian (CN) dhe do të përfshijë:

Nomenklaturën e Sistemit të Harmonizuar (SH) të Organizatës Botërore të Doganave;

nënndarjet, që i janë bërë nomenklaturës së SH-së, të quajtura ndryshe edhe “nënkrerë të NM-së”, të cilave u përgjigjet një nivel i caktuar i taksës doganore;

dispozitat paraprake, shënimet shtesë për seksionet, kapitujt dhe shënimet fundore për nënkrerët e NM-së.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë vendimin përkatës për përditësimin e Nomenklaturës së Mallrave me nivelet e tarifave doganore në fuqi, ku të përfshihen edhe nivelet e taksës doganore, kur është e mundur dhe njësitë statistikore plotësuese, si edhe informacione të tjera të nevojshme.

Vendimi i Këshillit të Ministrave përfshin nivelet bazë të taksës doganore ose ndryshe ato për kombin më të favorizuar (KMF), sipas përcaktimit të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Neni 2

Për të mundësuar zbatimin e njëkohshëm të tarifave doganore, të statistikave të tregtisë së jashtme dhe të politikave të ndryshme, në veçanti ato tregtare dhe bujqësore, për importimin dhe eksportimin e mallrave, Këshilli i Ministrave miraton tarifën e integruar të Shqipërisë, që do të quhet ndryshe dhe “Tarish”.

Tarish-i bazohet në Nomenklaturën e Mallrave dhe përfshin:

a) nënndarjet shtesë të nënndarjeve të NM-së, që do të quhen “nënkrerë të Tarish-it”, të cilat janë të nevojshme për përshkrimin e mallrave, që i nënshtrohen zbatimit të masave të veçanta, të dhëna në nenin 4;

b) nivelet e taksave doganore dhe të detyrimeve të tjera, që zbatohen në import ose eksport;

c) kodet numerike, që përmenden në nenin 3 pikat 2 dhe 3;

ç) nivelet tarifore preferenciale, që zbatohen në importimin ose eksportimin e mallrave të caktuara;

d) çdo të dhënë tjetër të nevojshme për vënien në jetë dhe administrimin e masave të vendosura në importimin apo eksportimin e mallrave, përfshirë edhe përjashtimet nga taksat.

Neni 3

Çdo nënkre i NM-së do të ketë një kod numerik me 8 shifra, ku:

gjashtë shifrat e para janë kodet numerike, që u përkasin krerëve dhe nënkrerëve të Nomenklaturës së Sistemit të Harmonizuar;

shifra e shtatë dhe e tetë identifikojnë nënkreun e NM-së.

Nënkrerët e Tarish-it do të identifikohen nga shifrat 9 dhe 10, të cilat, së bashku me kodet numerike, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, formojnë kodet numerike të Tarish-it.

Në raste përjashtimore, kode të tjera shtesë, përtej nivelit të dhjetë shifrave, mund t’u bashkëlidhen nënkrerëve të Tarish-it për të zbatuar masa specifike, të cilat nuk janë të koduara ose nuk janë plotësisht të koduara, në nivelin e shifrave 9 apo 10.

Neni 4

Masa të tjera të veçanta, përveç taksave doganore, që mund të merren për importimin ose eksportimin e mallrave, të përmendura në shkronjën “a” të nenit 2 të këtij ligji dhe që duhet të përfshihen në Tarish, janë:

1. Tatimi mbi vlerën e shtuar;
2. Akciza;
3. Pezullimet tarifore;
4. Kuotat tarifore;
5. Tarifat preferenciale (përfshi kuotat dhe tavanet);
6. Sistemi i përgjithshëm i preferencave tarifore, që zbatohen për vendet në zhvillim;
7. Taksat doganore antidumping dhe ato kundërbalancuese;
8. Taksa të tjera kundërbalancuese;
9. Vlerat për njësi;
10. Çmimet referuese dhe ato minimale;
11. Ndalimet në import;
12. Kufizimet në import;
13. Masa mbikëqyrëse në import;
14. Ndalimet në eksport;
15. Kufizimet në eksport;
16. Masa mbikëqyrëse në eksport;
17. Rimbursimet për eksport.

Neni 5

1. Nomenklatura e Mallrave, së bashku me nivelet e taksave doganore dhe detyrimet e tjera, si dhe masat e tjera, të përfshira në Tarish ose në dispozita të tjera ligjore, formojnë tarifën doganore të Republikës së Shqipërisë, për të cilën bën fjalë neni 28 i Kodit Doganor dhe që do të zbatohet në importimin e mallrave në Shqipëri.

2. Nomenklatura e Mallrave, përfshi kodet numerike dhe, kur është e përshtatshme, edhe njësitë statistikore plotësuese përkatëse, zbatohet për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave të tregtisë me jashtë.

Neni 6

1. Tarish-i përdoret nga organet doganore për zbatimin e të gjitha masave, që kanë lidhje me importimin në Republikën e Shqipërisë ose eksportimin nga Republika e Shqipërisë.

2. Kodet e Tarish-it zbatohen në të gjitha importimet e mallrave, që përfshihen në nënkreun përkatës. Kur është e nevojshme ato përdoren edhe në eksportimet e mallrave.

Neni 7

Tarish-i miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ai përcaktohet dhe bashkërendohet nga Komiteti për Nomenklaturën e Mallrave. Tarish-i përditësohet, administrohet dhe shpërndahet, në formë të shkruar dhe elektronike, çdo vit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Komiteti për Nomenklaturën e Mallrave, në bashkërendim me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Institutin e Statistikave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, ndërmerr, ndër të tjera, edhe këta hapa:

- a) përfshirjen në Tarish të të gjitha masave, që përmenden në nenin 4;
- b) krijimin e kodeve numerike në Tarish, sipas nevojave që do të dalin për zbatimin e masave;
- c) përditësimin e Tarish-it;
- ç) shpërndarjen, menjëherë, në format elektronik, të të gjitha ndryshimeve në Tarish.

Neni 8

Këshilli i Ministrave krijon Komitetin e Nomenklaturës së Mallrave, me përfaqësues nga Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Instituti i Statistikave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Në komitet mund të bëjnë pjesë edhe përfaqësues nga ministrinë e tjera të interesuara, me kërkesë të kryetarit.

Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e funksionimit të Komitetit të Nomenklaturës së Mallrave. Kryetar i komitetit është përfaqësuesi i Ministrisë së Financave.

Neni 9

Komiteti shqyrton çdo kërkesë, që i drejtohet atij nga kryetari, qoftë me nismën e këtij të fundit, qoftë me kërkesë të ndonjërit prej anëtarëve dhe që ka të bëjë me:

a) Nomenklaturën e Mallrave;

b) Nomenklaturën e Tarish-it dhe çdo nomenklaturë tjetër, të bazuar, tërësisht apo pjesërisht, në Nomenklaturën e Mallrave ose që shton ndonjë nënndarje në të, për të bërë të mundur zbatimin e masave tarifore ose të masave të tjera, lidhur me tregtinë e mallrave, të vendosura ose që parashikohet të vendosen me ndonjë dispozitë të veçantë.

Neni 10

1. Komiteti, në përputhje me procedurën e përshkruar në nenin 11 të këtij ligji, merr të gjitha masat, që i vlerëson të nevojshme, për çështjet si më poshtë:

a) zbatimin e Nomenklaturës së Mallrave dhe të Tarish-it, veçanërisht për:

i) klasifikimin e mallrave në nomenklaturën e përmendur në nenin 8 të këtij ligji;

ii) shënimet shpjeguese;

iii) krijimin, nëse është i nevojshëm, të nënndarjeve statistikore në Tarish, për t'iu përgjigjur nevojave;

b) përditësimin e Nomenklaturës së Mallrave, në përputhje me Nomenklaturën e Kombinuar të Bashkimit Europian;

c) rregullimin e niveleve të taksave, në përputhje me vendimet e marra nga Kuvendi.

2. Dispozitat, që do të miratohen në përputhje me pikën 1 të këtij neni, nuk mund të ndryshojnë:

a) nivelet e taksave doganore dhe të detyrimeve të tjera, të përcaktuara me ligj;

b) kufizimet sasiore në importimin ose eksportimin e mallrave, të përcaktuara me ligj.

3. Nëse është e nevojshme, duhet të bëhen menjëherë ndryshimet në nënkrerët e Nomenklaturës së Mallrave dhe të Tarish-it. Pavarësisht nga kjo, të gjitha ndryshimet duhet të përfshihen detyrimisht në një botim të vetëm, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji.

Neni 11

Ministria e interesuar duhet të paraqesë në komitet një projekt të masës, që është në fuqi ose që parashikohet të ndërmerret. Komiteti duhet që, brenda afatit kohor, të formulojë një opinion, të përcaktuar nga kryetari, në përputhje me rëndësinë dhe urgjencën e çështjes. Opinioni duhet të tregojë mënyrën se si duhet të formulohet akti, për t'u bërë e zbatueshme masa që duhet të merret.

Këshilli i Ministrave miraton masën e propozuar, në përputhje me projektin e komitetit.

Neni 12

Këshilli i Ministrave duhet të miratojë çdo vit një vendim për riprodhimin e versionit të plotë të Nomenklaturës së Mallrave, së bashku me nivelet e taksave, në bazë të vendimeve të marra nga Kuvendi për paketën fiskale për vitin pasardhës. Vendimi duhet të botohet në Fletoren Zyrtare jo më vonë se data 15 dhjetor dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 janari i vitit pasardhës.

Masat dhe të dhënat për tarifën doganore dhe Tarish-in duhet, kur është e mundur, të

shpërndahen në format elektronik me mjete kompjuterike.

Këshilli i Ministrave, për të siguruar zbatimin në mënyrë uniforme të tarifës doganore dhe të Tarish-it, duhet të nxisë bashkëpunimin dhe harmonizimin e praktikave ndërmjet ministrive të ndryshme, duke përdorur mjetet kompjuterike.

Neni 13

Ligji nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore”, të ndryshuar, si dhe të gjitha dispozitat e tjera, që bien ndesh me dispozitat e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2006.

Shpallur me dekretin nr.4737, datë 28.12.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468
Për më tepër informacion vizitoni faqen e internetit:
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1000
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	500
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	500
4. INDEKSI ALFABETIK	600

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 17.1.2006

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë